

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2025

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
1.	31.12.2025	<p>Përshëndetje,</p> <p>Që me komunikimin e datës, 16.04.2025 ora 1:07 PM të IKMT-së ku më është komunikuar se nuk mund të mundësohet kopje e shkresës me nr. 38/4 prot. datë, 27.02.2025 të DRIKMT Lezhë si dhe kopje të procesverbalit nr. 02 datë, 26.02.2025 “Për konstatimin e kundërvajtjes” për arsyen se procedura në fjalë është ende në shqyrtim ndaj nuk mund të bëhen publikime deri në përfundimin e procesit, shprehem se IKMT me kthimin e përgjigjes së datës, 09.12.2025 të ankesës time me numër gjurmimi MB-2025-6245217-BI më ka komunikuar qëndrimin e mbajtur me shkresën nr. 20211 prot. datë, 25.11.2025 të IVMT pranë Bashkisë Lezhë</p>	07.01.2025	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se referuar ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe të ligjit Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t’ju vihet në dispozicion pasi aktet përmbajnë të dhëna të cilat i përkasin një subjekti tjetër.</p> <p>Faleminderit,</p>		

		<p>dhe në vlerësimin tim nuk ka më argumenta nga IKMT për trajtimin e ankesës time dhe në këto kushte procesi ka të dhëna që është përfunduar. Per sa me siper ne zbatim dhe te ligjit nr. 119/2014 “Per te drejten e informimit” kerkoj te dhena te regjistruara ne çfaredo lloj forme dhe formati, gjate ushtrimit te funksionit publik nga institucioni i Inspektoriatit Kombetare te Mbrojtjes se Territorit ne lidhje me, te me veje ne dispozicion nje kopje te shkreses me nr. 38/4 prot. date, 27.02.2025 te Drejtorise Rajonale te IKMT Lezhe dhe te procesverbalit nr. 02 date, 26.02.2025 me nr. serie 00001802 “Per konstatimin e kundravajtjes”. Duke ju falenderuar, mbetem ne pritje te nje pergjigjeje nga ana e institucionit tua</p>				
2.	09.01.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të informacionit të shkëmbyet më sipër, rezulton se arkëtimet nga gjobat për të njëjtat</p>	16.01.2026	<p>E nderuar,</p> <p>Referuar pyetjes lidhur me diferencën e numrit të gjobave ndërmjet periudhave janar–maj 2024 dhe janar–maj 2025, sqarojmë</p>	E plote	Nuk ka

		<p>periudha (janar-maj) në vitin 2025 janë ulur me 74 %.</p> <p>Konkretisht, sipas të dhënave që Sectori keni vënë në dispozicion, rezulton se vlera e gjobave ka lëvizur, nga 896 mln → në 226 mln ↘ -74%</p> <p>Për sa më sipër, ju drejtojmë pyetjen:</p> <p>4. Si e shpjegoni këtë rënie, a ka ndonjë element Sectorial që e justifikon?</p> <p>Të dhënat e grumbulluara dhe përgjigjja juaj do të përdoret në kuadër të një artikulli investigues. Faleminderit</p>	<p>se ndryshimi varet kryesisht nga intensiteti dhe shtrirja e inspektimeve në terren, numri i rasteve të konstatuara në shkelje të ligjit, kërkesat e qytetarëve, si dhe kërkesat për ndërhyrje dhe bashkëpunim nga institucione të tjera.</p> <p>E rëndësishme të theksohet se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka kompetencë për kontrollin, parandalimin dhe goditjen e ndërtimeve të kundërligjshme në zonat me rëndësi kombëtare. Ky kontroll përfshin zonat prioritare për zhvillimin e turizmit, monumentet dhe qendrat historike, zonat e mbrojtura natyrore dhe arkeologjike, vijën bregdetare, burimet ujore kryesore, si dhe infrastrukturën dhe objektet strategjike të rëndësisë kombëtare. Për shkak të karakterit të paparashikueshëm të konstatimeve të ndërtimeve të kundërligjshme dhe të fushave të ndryshme të punës së IKMT-së, përfshirë ndërtimin, mjedisin dhe pyjet, si dhe për shkak të shtrirjes</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>kombëtare të kompetencave, intensiteti dhe shtrirja e inspektimeve ndryshon nga një vit në tjetrin, duke ndikuar drejtpërdrejt në numrin e gjobave. Gjithashtu, gjatë periudhës janar–maj 2024, IKMT ka qenë e përfshirë në disa projekte me interes publik dhe ka zbatuar Urdhërin e Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 16.02.2024, për ndalimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve të mjeteve motorike dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit pranë akseve kombëtare. Këto aktivitete kanë çuar në një rritje të ndjeshme të numrit të inspektimeve dhe procedurave të kryera gjatë asaj periudhe, gjë që shpjegon pjesërisht ndryshimin e numrit të gjobave krahasuar me periudhën e mëvonshme.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,</p>		
3.	12.01.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Kerkojme informacion ne lidhje me vendimin bashkelidhur</p>	23.01.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj dhe në vijim të inspektimit të kryer më</p>	E plote	Nuk ka

		<p>“Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar” të marrë nga Komisioni I shqyrtimit të ankimeve, INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT për bashkinë Krujë 5en j poshtë:</p> <p>A është zbatuar ky vendim? A është paguar nga ana e bashkisë Krujë gjatë e venë sipas këtij vendimi? Nëse po, kur është paguar dhe cila është shuma?</p> <p>Në pritje 5en je përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj,</p>		<p>datë 25.05.2025 në zonën Kodër-Dollak, Fushë Krujë, Bashkia Krujë, Qarku Durrës, ju bëjmë me dije sa vijon:</p> <p>Bazuar në nenin 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.02.2009, “Për kundërvajtjet administrative”, citohet se:</p> <p>“Gjohja dhe shumata që duhet të paguhet sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjohje, i cili përbën titull ekzekutiv. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonësë paguhet kamatëvonesë prej 2% në muaj të masës së gjohës, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme.”</p> <p>Subjekti, Bashkia Krujë, ka marrë dijeni për vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve Administrative më datë 30.07.2025 dhe kishte një afat prej</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>10 ditësh për kryerjen e pagesës së gjobës.</p> <p>Pas përfundimit të afatit ligjor dhe për shkak të moskryerjes së pagesës në mënyrë vullnetare, IKMT ka dërguar kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit më datë 06.10.2025 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Më pas, më datë 19.11.2025, jemi njoftuar nga gjykata se kërkesa për lëshimin e urdhrin është pranuar pjesërisht, pra është pranuar lëshimi i urdhrin për gjobën dhe është refuzuar lëshimi i urdhrin për kamatëvonesën. Ndaj pjesës së vendimit që ka të bëjë me kamatëvonesën, nga ana jonë është ushtruar ankim po në datën 19.11.2025.</p> <p>Aktualisht, jemi në pritje të njoftimit zyrtar të vendimit për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit dhe dërgimit të kopjes origjinale të tij nga gjykata, në mënyrë që më pas të procedojmë me ekzekutimin e gjobës nëpërmjet shërbimit</p>	
--	--	--	---	--

				<p>përmbardimor, siç përcaktohet nga Kodi i Procedurës Civile.</p> <p>Ju falënderojmë për mirëkuptimin.</p>		
04.	12.01.2025	<p>Pëshëndetje,</p> <p>Në bazë të ligjit .nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, jeni të lutur të gjeni mëposhtë pyetjet tona të kësaj kërkesë për informacion.</p> <p>Po ju dërgoj disa pyetje në këtë kërkesë për informacion:</p> <p>1.Sa është numri i rasteve të identifikuar nga ana juaj gjatë periudhës 2015-2025, ku si rezultat i veprimtarisë së bizneseve të mëdha janë shkelur rregulloret dhe ligjet për mbrojtjen e mjedisit? Ju lutem, specifikoni rastet sipas zonave (rurale dhe urbane) dhe llojit të ndotjes së shkaktuar.</p> <p>2.Cilat janë masat administrative apo ndëshkimore të ndërmarra ndaj këtyre bizneseve? Ju lutem,</p>	03.02.2025	<p>Pëshëndetje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, lidhur me rastet e identifikuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), përmes Drejtorisë së Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, ju informojmë se:</p> <p>Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave është ngritur dhe ka filluar funksionimin si pjesë e strukturës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në periudhën nëntor të vitit 2020. Për rrjedhojë, IKMT nuk disponon të dhëna lidhur me subjektet e gjobitura apo masat administrative të marra për ndotje të shkaktuara para këtij viti.</p> <p>Sa i përket numrit të subjekteve që, përmes veprimtarisë së tyre, kanë rezultuar në shkelje të legjislacionit</p>	E plote	Nuk ka

		na specifikoni masat e sakta për secilën ngjarje/rast të identifikuar.		<p>në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, ju informojmë se numri mesatar vjetor i rasteve varion nga 100 deri në 150 raste në vit.</p> <p>Nga këto raste, rreth 55%–65% kanë ndodhur në zona industriale, ndërsa pjesa tjetër në zona rurale dhe urbane. Sa i përket natyrës së shkeljeve të konstatuara, në rreth 60% të rasteve ndotja është shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve të parrezikshme dhe të rrezikshme, në rreth 20% të rasteve nga ndotja e ajrit, në rreth 25% të rasteve nga shkarkime të ujërave të ndotura urbane dhe industriale të patrajtuara në mjedisin pritës ujqor dhe/ose tokësor, ndërsa në rreth 5% të rasteve është konstatuar ndotje akustike, fenomen ky më i theksuar në zonat urbane të banuara.</p> <p>Masat administrative janë vendosur në përputhje me natyrën e shkeljeve të konstatuara dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi. Për shkeljet në fushën e menaxhimit të mbetjeve është aplikuar ligji nr. 10463 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i cili parashikon masa</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>administrative në vlerën nga 1.500.000 lekë deri në 2.000.000 lekë, të shoqëruara, në shumicën e rasteve, me pezullim të pjesshëm ose të përkohshëm të aktivitetit që ka kryer kundërvajtjen, si dhe me referimin e rasteve pranë Policisë së Shtetit për kallëzim penal.</p> <p>Për shkeljet që lidhen me shkarkimet e pakontrolluara të ujërave, si dhe me përdorimin e burimeve ujore nëntokësore apo sipërfaqësore pa lejen përkatëse administrative, janë zbatuar masat administrative të parashikuara në ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, të cilat variojnë nga 500.000 lekë deri në 2.000.000 lekë, të shoqëruara me pezullim të pjesshëm ose të përkohshëm të aktiviteteve, ndërsa në rastet e shfrytëzimit të lumenjve, të gjitha rastet janë referuar pranë Policisë së Shtetit për kallëzim penal.</p> <p>Për ndotjen e ajrit, në zbatim të ligjit nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit”, janë marrë masa administrative që variojnë nga 1.000.000 lekë të reja deri në 2.000.000 lekë të reja, si dhe</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				pezullim i pjesshëm ose i përkohshëm i burimit ndotës, qoftë aktivitet, makineri dhe/ose pajisje, ndërkohë që është kërkuar vlerësim nga ekspertë dhe institucione të tjera kompetente për të përcaktuar ekzistencën e ndotjes së lartë, me qëllim referimin e çështjes pranë organit të prokurorisë. Faleminderit.		
05	15.01.2026	<p>Pëshëndetje,</p> <p>Kam bere ankesen ne lidhje me prerjen e pyllit, te dhenat e bashkelidhura ne shkresat zyrtare te derguara edhe zyrtarisht nga avokati po ju nis edhe fotot e bera ne momentin fragrant te prerjes se pyllit. Kerkoj nga ana juaj te rishikohet ceshtja dhe te zbatohet ligji .</p> <p>Ju Faleminderit!</p>	24.02.2026	<p>Përshendetje ,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion për veprimtarinë e shoqërisë “ASI RENT 2020” Sh.P.K., Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:</p> <p>IKMT, respektivisht Drejtoria e Inspektimeve të Pyjeve, më datë 26.01.2026, ngriti grupin e punës për verifikim në vend, ku rezultoi se veprimtaria e kësaj shoqërie vazhdon të jetë e pezulluar. Pasi u mor kontakti me administratorin, na informoi se hapja e rrugës është kryer nga një nënkontraktor, i cili ka kontratë shërbimi për kryerjen e punimeve për hapjen e rrugëve. Gjithashtu administratori paraqiti lejen e revokimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe</p>	E plote	Nuk ka

				<p>shprehu gadishmërinë për vënien në dispozicion të dokumentacionit, të cilat aktualisht i dispononte avokati, pasi ishin në proces gjyqësor. Gjithashtu administratori na informoi se shoqëria nuk ka filluar aktivitetin që nga marrja e lejes.</p> <p>Nëse dokumentacioni nuk na vendoset në dispozicion brenda afateve të përcaktuara, do të ndiqen procedurat e nevojshme ligjore, përt marrjen e masave administrative. Duke Ju falenderuar,</p> <p>Pershendetje,</p> <p>Në përgjigje të ankesës suaj, ju sqarojmë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në bazë të urdhrit të Kryeinspektorit, më datë 03.03.2026, kreu inspektim në vendin e quajtur Brataj, ekonomia pyjore Mali i Bratit–Gumenicë, ngastra 6/a, Bashkia Selenicë.</li><li>2. Nga inspektimi i ushtruar në terren, u verifikua sipërfaqja e dëmtuar/prerë nga subjekti “Asi Rent 2020” sh.p.k.</li></ol>	
--	--	--	--	--	--

				<p>3. Për shkeljen në fjalë, ndaj subjektit është marrë masë administrative nga Bashkia Selenicë, konkretisht dënim me gjobë dhe pezullim i aktivitetit minerar.</p> <p>Duke qenë se ndaj subjektit është marrë masë administrative (dënim me gjobë dhe pezullim i aktivitetit) nga Bashkia Selenicë, ju informojmë se nuk mund të merret masë administrative dy herë për të njëjtën shkelje.</p> <p>Nëse përsëri konstatoi ndërhyrje në zonë, jeni të lutur të na informoni.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!</p>		
06	03.02.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Gjeni bashkelidhur kërkesën për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit: per subjektin “Vokopola Energji”sh.p.k</p>	12.02.2026	<p>Përsëritje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>IKMT, respektivisht Drejtoria e Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, ka realizuar në subjektin “Vokopola Energji” sh.p.k., me një inspektim</p>		

		<p>Ne pritje te pergjigjes Tuaj brenda afatit ligjor .</p>		<p>shkresor 2-ditor, nëpërmjet platformës unike E-Inspektimi, me numër çështjeje NR.IKMT-DQ-2025-00014-1, me datë 17.07.2025 dhe 18.07.2025, me objekt inspektimi: “Verifikim mbi zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit ‘Për Burimet Ujore’”.</p> <p>Në përfundim të këtij inspektimi, bazuar në rezultatet e dala, është mbajtur edhe Vendimi Përfundimtar i Inspektimit, pa masë administrative, NR.IKMT-DQ-2025-00014-5, datë 18.07.2025. Subjekti i inspektuar “Vokopola Energji” sh.p.k, ka në përdorim dhe shfrytëzim tre (3) HEC-e, të cilët janë ndërtuar në Basenin Ujor Seman. Të tre këto vepra të prodhimit të hidroenergjisë janë të pajisura me</p> <p>Leje të Përdorimit të Burimit Ujor me qëllim për Prodhim Energjie, e përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. L.U. Nr. serie 19, Nr.1616/1.Prot, datë 09.12.2020, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=4210523856, Y=4487004,6905, Z=242.</li> </ol>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>2. L.U. Nr. serie 20, Nr.1617/1.Prot, datë 09.12.2020, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=4237254335, Y=44910870523, Z=170.</p> <p>3. L.U. Nr. serie 63, Nr.496.Prot, datë 07.07.2022, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=501959.9, Y=4483957.3, Z=440.35 m n.m.d.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!</p>		
07	04.02.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Po ju drejtohem lidhur me ankesën time për ndotje mjedisore dhe stalla me bagëti pranë banesave, e regjistruar me nr. çështjeje 920748, e cila është përcjellë për verifikim pranë institucionit tuaj.</p> <p>Deri në këtë moment, përveç njoftimeve automatike se çështja “po trajtohet”, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje konkrete në terren, ndërkohë që problemi vazhdon dhe po përkeqësohet çdo ditë.</p>	25.02.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>IKMT – Drejtoria Rajonale Durrës, Sektori i Mjedisit dhe Ujërave, është paraqitur në terren për të kryer verifikimet përkatëse, nga ku u konstatua prezenca e dy stallave të ndodhura në një zonë rurale, në fshatin Rrushkull, Njësia</p>	E plote	Nuk ka

		<p>Stallat me bagëti ndodhen shumë pranë shtëpive ku banojnë mbi 11 familje dhe po shkaktojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndotje të rëndë mjedisore,</li> <li>• erë të padurueshme dhe mbetje,</li> <li>• zhurmë të vazhdueshme,</li> <li>• rrezik real për shëndetin e banorëve.</li> </ul> <p>Duke qenë se janë konsumuar edhe ankesat pranë pushtetit vendor pa asnjë rezultat, ju lutem të kryeni sa më parë verifikimin në terren dhe të na informoni konkretisht për hapat që do të ndërmerren dhe afatet për zgjidhjen e kësaj situatë.</p> <p>Mbetem në dispozicion për çdo informacion shtesë dhe jam i gatshëm të bashkëpunoj për sqarime apo prova të mëtejshme. Ju falënderoj për vëmendjen dhe pres një reagim konkret nga ana juaj.</p> <p>Me respekt,</p>		<p>Nga ana e Drejtorisë Rajonale Durrës, duke qenë se, referuar numrit të kafshëve të imta që disponojnë, nuk përmbushet kriteri i përcaktuar në Shtojcën 1 të Ligjit nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, të ndryshuar”, nuk është objekt për pajisje me Leje Mjedisi. Si rrjedhojë, nuk përbën kundërvajtje administrative, pasi nuk përmbushet kapaciteti prej më shumë se 50 (njësi) vende gjedhi të konvertuara.</p> <p>Ju bëjmë me dije se: Për kryerjen e verifikimeve në lidhje me plotësimin e kushteve konform Ligjit nr. 9426, datë 06.10.2005, “Për mbarështimin e blegtorisë”, çështja është deleguar për kompetencë pranë Drejtorisë Bujqësore Durrës, si dhe Bashkisë Durrës. Gjithashtu, IMT – Bashkia Durrës është ngarkuar për verifikimin e ligjshmërisë së objektit që është subjekt i kësaj ankese.</p> <p>Faleminderit.</p>		
08	09.02.2026	<p>Të nderuar,</p> <p>Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të një subjekti që ushtron aktivitet</p>	23.02.2026	<p>Përsëndetje, Në përgjigje të ankesës suaj paraqitur pranë Koordinatorit për të</p>	E plote	Nuk ka

		<p>në qytetin e Korçës, po ju drejtohem për të paraqitur një ankesë zyrtare lidhur me shkeljen e të drejtave të subjektit gjatë një veprimi të pretenduar inspektues.</p> <p>Në datën 09.02.2026, pranë ambienteve të aktivitetit janë paraqitur disa persona që janë prezantuar verbalisht si inspektorë, pa paraqitur asnjë dokumentacion identifikues apo autorizues, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pa urdhër pune,</li> <li>• pa bexhë identifikimi,</li> <li>• pa veshje zyrtare apo jelek me logo të institucionit përkatës (IKMT),</li> <li>• pa asnjë dokument që të vërtetonte statusin e tyre zyrtar.</li> <li>• makine me targa të huaja gjermane</li> </ul> <p>Personat në fjalë kanë tentuar të kryejnë veprime me natyrë inspektuese, duke krijuar pasiguri juridike dhe duke cenuar të drejtat e subjektit. Siç evidentohet edhe nga fotot/video bashkëngjitur, mungon çdo element identifikues zyrtar, në kundërshtim të hapur me procedurat ligjore të inspektimit si dhe komunikim</p>		<p>Drejtën e Informimit, ju bëjmë me dije sa vijon:</p> <p>Pas shqyrtimit të ankesës dhe pamjeve filmike të dërguara nga ana juaj, si dhe bazuar në informacionin e dhënë nga inspektorët e DRIKMT Korçë, rezulton se punonjësit e institucionit kanë kryer një verifikim të menjëhershëm në terren, pasi është konstatuar prania e një sasive gomash të përdorura të hedhura në një parcelë bujqësore.</p> <p>Gjatë verifikimit, u kërkua që gomat të hiqeshin dhe të depozitoheshin brenda objektit ku ushtrohet aktiviteti, pasi situata përbënte ndotje mjedisore.</p> <p>Në këtë rast nuk është ushtruar kontroll administrativ, pasi nuk është kërkuar dokumentacion apo të jetë mbajtur procesverbal.</p> <p>Për sa i përket ankesës lidhur me mungesën e jelekeve gjatë verifikimit, sqarojmë se kushtet klimatike kanë qenë jo të favorshme, çka ka ndikuar në mosmbajtjen e uniformës.</p> <p>Megjithatë, ju bëjmë me dije se inspektorëve u është tërhequr vëmendja për shkak të moszbatimit të rregullave të etikës.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>verbal ne forme presioni te ushtruar ndaj punonjesve pa kerkuar pranine e administratorit te subjektit.</p> <p>Bazuar në legjislacionin në fuqi, çdo inspektim është i vlefshëm vetëm nëse kryhet me urdhër pune dhe nga inspektorë të identifikueshëm, ndaj çdo veprim i kryer në këto kushte konsiderohet i pavlefshëm dhe i paligjshëm.</p> <p>Në këtë kuadër, kërkoj:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Verifikimin zyrtar të personave që janë paraqitur si inspektorë.</li><li>2. Konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të kryera.</li><li>3. Marrjen e masave përkatëse administrative, nëse konstatohet shkelje.</li><li>4. Garanci që çdo inspektim i ardhshëm të kryhet vetëm në përputhje me ligjin.</li><li>5. Informimin tim me shkrim mbi përfundimet e shqyrtimit të kësaj ankese.</li></ol> <p>Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.</p>		Ju falënderojmë.		
--	---	--	------------------	--	--

		Me respekt,				
09	12.02.2026	Pershendetje,  Bashkelidhur ankesen time.	13.02.2026	Pershendetje ,  Drejtuar: Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Vlorë  Për dijeni: Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.  Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit!	Deleguar IMT Bashkia Vlore	Nuk ka
10	16.02.2026	Ju lutem vini në dispozicion numrin e kontrolleve të kryera ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet  shfrytëzimi pyjor (për prerjen)  1. Numri dhe vlera e gjobave të vendosura për shkelje ligjore në fondin pyjor.	03.03.2026	Pershendetje,  Në vijim të kërkesës për informacion në lidhje me numrin e kontrolleve të kryera ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi pyjor, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:  Gjatë viteve 2023, 2024 dhe deri në Tetor të Vitit 2025, Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, në bazë të Udhëzimit Nr.17, datë 20.4.2023,	E plote	Nuk ka

		<p>2. Lloji i shkeljeve të konstatuara (p.sh. prerje jashtë parcelës, tejkalim volumesh, mungesë dokumentacioni, transport i paligjshëm etj).</p> <p>3. Numri i rasteve të prerjeve të paligjshme të konstatuara dhe masat e marra.</p> <p>4. Rastet e pezullimit apo heqjes së licencës ndaj operatorëve për shkelje të legjislacionit pyjor.</p> <p>5. Rastet e referuara për ndjekje penale.</p>		<p>“Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve”, nga IP është hequr akses i IKMT tek portali unik “e-inspektimi”.</p> <p>Por IKMT në referencë të VKM Nr.893/2015 ‘Për organizimin e funksionimit të IKMT’ dhe Urdhrit Nr 22, datë 3.2.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukture dhe organikës së IKMT”, ka jo vetëm kompetencë por detyrë:</p> <p>Kontrollin, mbrojtjen e territorit dhe të peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.”.</p> <p>Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve ka ushtruar detyrat inspektuese pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në zbatim të VKM Nr.604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>Referuar këtyre detyrave, gjatë Vitit 2023 janë realizuar në rang kombëtar 1001 inspektime, Për periudhën Janar-Prill 2023, nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur 13 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 20.</p> <p>Gjatë Vitit 2024 nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë realizuar në rang kombëtar 1623 inspektime, ku janë mbajtur 2 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 2.</p> <p>Gjatë Vitit 2025 nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë realizuar në rang kombëtar 1045 inspektime, ku janë mbajtur 9 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 0.</p> <p>Kryesisht masat e mbajtura nga Drejtoria e Pyjeve konsistojnë në transport të paligjshëm të materialit drusor, pa dokumentacion shoqërues tekniko-ligjor, gjermime në fond pyjor, si dhe gjueti.</p> <p>Duke ju falenderuar,</p>		
--	--	--	--	--	--

11	18.02.2026	Pershendetje,  Bashkelidhur ankesen time.	18.02.2026	<p>Pershendetje ,</p> <p>Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë</p> <p>Në dijeni:.</p> <p>Në adresëne-mai e lit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa , me nr. 11 Rendor, datë 18.02.2026</p> <p>Bashkelidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur.</p> <p>Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>	Deleguar IMT Bashkia Lezhe	Nuk ka
12	19.02.2025	Pershendetje,  Bashkelidhur ankesen time	20.02.2025	<p>Pershendetje,</p> <p>Më poshtë do të gjeni përgjigjen e Bashkisë Tiranë.</p> <p>Faleminderit.</p> <p><i>Pershendetje</i></p> <p><i>Në përgjigje të ankesës së ardhur me e-mail, ju bëjmë me dije se:</i></p>		

				<p><i>Pas kontrollit të ushtruar nga punonjësit e Policisë Bashkiake në Njësinë Administrative Nr. 10, rruga “Reshit Çollaku”, Bashkia Tiranë, ju informojmë se në momentin e kontrollit nuk është konstatuar tejkalim i hapësirës publike.</i></p> <p><i>Lidhur me pretendimin se ka nderyrje ne strukturen e pallatit, instalacionet dhe tubin e aspirimit të vendosura nga ky subjekt, nëpërmjet Sallës së Drejtimit dhe Koordinimit është njoftuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) për verifikimin dhe ndjekjen e problematikës, sipas kompetencave të tyre ligjore.</i></p> <p><i>Duke ju falenderuar.</i></p>		
13	24.02.2026	<p>Kërkoj të më vihen në dispozicion informacioni dhe dokumentat e mëposhtëm për lumenjtë dhe përrenjtë</p> <p>kryesorë të Parkut Shebenik–Jabllanicë:</p> <p>1. Sa inspektime janë kryer nga IKMT në territorin e Parkut Shebenik–Jabllanicë nga viti 2018 deri</p>	03.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen ndaj kërkesës për informacion.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka

		<p>sot?</p> <p>2. Sa masa administrative (gjobë, pezullim, paralajmërim) janë vendosur për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ shkelje të rrjedhës ekologjike</li> <li>○ devijime të paligjshme uji?</li> </ul> <p>3. Ju lutemi të na vini në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ kopje të vendimeve të gjobave</li> <li>○ procesverbalet përkatëse (me të dhëna personale të anonimizuara).</li> </ul> <p>4. A ka IKMT akses në vetëmonitorimet mjedisore periodike të dorëzuara në AKM nga subjektet e ndryshme në këtë park apo rang territori?</p>				
14	23.02.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit ju falënderojmë për përgjigjen tuaj dhe për shqyrtimin e ankesës sonë lidhur me verifikimin e kryer nga persona të</p>	06.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Bashkëlidhur gjeni përgjigjen për kërkesën.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka

	<p>prezantuar si inspektorë të IKMT Rajoni Korçë, në datën 09.02.2026.</p> <p>Vlerësojmë angazhimin tuaj dhe sqarimet e dhëna. Megjithatë, në funksion të një kuptimi sa më të plotë dhe korrekt të situatës, dëshirojmë të paraqesim disa sqarime dhe konsiderata shtesë.</p> <p>Gjatë paraqitjes së personave në ambientet e subjektit tonë, nuk është paraqitur urdhër pune, dokument identifikimi zyrtar apo dokument autorizues që provon cilësinë funksionale, si dhe nuk janë mbajtur shenja dalluese apo uniformë (për të cilin kemi marrë sqarimin përkates por justifikues).</p> <p>Në këtë kontekst, ushtrimi i pretenduar i funksionit inspektues është perceptuar në kundërshtim me standardet bazë të identifikimit dhe transparencës që duhet të shoqërojnë çdo veprim administrativ.</p> <p>Gjithashtu, mënyra e komunikimit dhe sjellja e mbajtur ndaj përfaqësuesve të subjektit u perceptua me tone joetike dhe urdhëruese, pa respektim të</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>parimit të trajtimit korrekt dhe proporcional, çka përbën edhe arsyen kryesore që na shtyu në paraqitjen e kësaj ankese.</p> <p>Dëshirojmë të theksojmë se kjo është hera e parë që subjekti ynë paraqet një ankesë të tillë, pavarësisht se kemi pasur edhe një verifikim të mëparshëm nga e njëjta zyrë gjatë muajit Tetor 2025. Në atë rast, për shkak të mungesës së provave filmike, nuk kemi vijuar me ankesë formale.</p> <p>Nga ana tjetër, lidhur me konstatimin e disa mbetjeve (goma të përdorura), sqarojmë se ato ndodhen në një parcelë jashtë pronës dhe administrimit të subjektit tonë, dhe për rrjedhojë çdo lidhje e krijuar midis subjektit dhe këtyre mbetjeve është e pabazuar dhe cenon reputacionin e tij.</p> <p>Për sa më sipër, do të vlerësonim një rishqyrtim të plotë të rastit, si dhe:</p> <p>Verifikimin e respektimit të detyrimit për identifikim dhe autorizim;</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>Sqarimin e bazës ligjore mbi të cilën është kryer verifikimi në terren;</p> <p>Vlerësimin e respektimit të standardeve të etikës së funksionarit publik;</p> <p>Identifikimin zyrtar të personave të përfshirë;</p> <p>Informimin me shkrim mbi përfundimet e shqyrtimit.</p> <p>Duke qenë se kjo është ankesa e parë e paraqitur nga ana jonë, shpresojmë që të mbetet edhe e fundit, pasi situata konkrete – komunikimi joetik dhe paraqitja jashtë protokolleve të rregullta – ishte arsyeja që na detyroi të ndërmarrim këtë hap.</p> <p>Mbetemi të hapur për bashkëpunim dhe mirëkuptim reciprok, në funksion të respektimit të ligjit dhe standardeve institucionale.</p> <p>Me respekt,</p>				
15	25.02.2025	Në bazë të ligjit nr.119/2014	11.03.2025	Përshëndetje,	E plote	Nuk ka

		<p>“Për të drejtën e informimit”, kërkojmë vënien në dispozicion të dokumentacionit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Informacion nëse Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ushtruar kontrolle në terren gjatë realizimit të punimeve ndërtimore të projektit “Manastiri Resort”, Gjiri i Manastirit, Bashkia Sarandë.</li> <li>2. Në rast se janë ushtruar kontrolle, kopje të: procesverbaleve të inspektimit, raporteve të kontrollit në terren, konstatimeve administrative të hartuara nga inspektorët.</li> <li>3. Dokumentacion mbi çdo masë administrative të ndërmarrë nga IKMT lidhur me punimet ndërtimore të këtij objekti.</li> <li>4. Çdo urdhër pezullimi punimesh, vendim administrativ ose akt tjetër të nxjerrë nga IKMT në lidhje me realizimin e projektit.</li> <li>5. Dokumentacion fotografik ose material tjetër shoqërues i hartuar gjatë kontrolleve në terren.</li> </ol>		<p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju dërgoj përgjigjen zyrtarë. Dokumenti i bashkëngjitur përmban të gjithë informacionin e detajuar.</p> <p>Ju falënderoj për mirëkuptimin.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		6. Çdo komunikim institucional i zhvilluar nga IKMT me autoritete të tjera shtetërore lidhur me kontrollet ndërtimore të ushtruara për këtë objekt.				
16	24.02.2025	<p>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A ka kryer IKMT inspektime në kantierin e ndërtimit të aksit Rrogozhinë - Elbasan gjatë periudhës së realizimit të punimeve?</li> <li>2. Nëse po, ju lutem të na vini në dispozicion informacion mbi numrin e inspektimeve të kryera dhe konstatimet kryesore administrative.</li> <li>3. A janë evidentuar masa administrative, rekomandime teknike apo ndërprerje të përkohshme punimesh gjatë realizimit të projektit?</li> </ol>	10.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju dërgoj përgjigjen zyrtare lidhur me inspektimet në kantierin e aksit rrugor Rrogozhinë–Elbasan. Dokumenti i bashkëngjitur përmban të gjithë informacionin e detajuar.</p> <p>Ju falënderoj,</p>	E plote	Nuk ka
17	25.02.2026	<p>Kërkesë për inspektim urgjent dhe pezullim punimesh ndërtimore pranë pallatit tonë”. :</p> <p><b>I. RRETHANAT FAKTIKE</b></p> <p>Punimet në objektin shumëkatësh kanë rifilluar me intensitet të lartë pas një periudhe ndërprerjeje.</p>	30.03.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Bashkelidhur po ju dergojme kthimin e pergjigjes se ankeses suaj.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka

		<p>Aktualisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Po kryhen gërmime për tre kate nën tokë në distancë kritike nga pallati ekzistues;</li> <li>• Është dëmtuar infrastruktura ekzistuese e ujërave të bardha dhe të zeza;</li> <li>• Është cenuar sistemi ekzistues i drenazhimit;</li> <li>• Punimet zhvillohen në terren të pjerrët;</li> <li>• Ndërtesa e re e rrethon pallatin tonë në tre drejtime.</li> </ul> <p>Këto rrethana krijojnë rrezik real për destabilizim strukturor dhe përmbytje.</p> <hr/> <p><b>II. BAZA LIGJORE</b></p> <p>Referuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”</li> <li>• VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”</li> <li>• Detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së objekteve fqinje</li> <li>• Detyrimit për mbrojtjen e infrastrukturës publike</li> </ul>				
--	--	---	--	--	--	--

Ndërtimi nuk duhet të cenojë sigurinë strukturore të objekteve ekzistuese dhe as të dëmtojë rrjetet publike.  
Dëmtimi i rrjetit të ujërave përbën shkak të mjaftueshëm për pezullim të menjëhershëm të punimeve deri në verifikim të plotë teknik.

---

### **III. KËRKESAT**

Kërkojmë:

1. Inspektim urgjent në terren;
2. Pezullim të menjëhershëm të punimeve;
3. Verifikim të përputhshmërisë së punimeve me projektin e miratuar;
4. Vlerësim të sigurisë strukturore të pallatit ekzistues;
5. Verifikim të dëmtimit të infrastrukturës publike.

Situata paraqet emergjencë reale dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

Lidhur me sa më sipër, ankesa jonë është dërguar edhe me postë (bashkangjitur kopie) tek ju dhe dega rajonale e Vlorës, por

		<p>emergjenca e imponon edhe këtë komunikim.</p> <p>Faleminderit!</p>				
18	24.02.2026	<p>Në të njëjtin kat ndodhen edhe tre njësi të tjera tregtare, të cilat janë në pronësi të një subjekti tjetër. Ky i fundit ka kryer ndërhyrje të njëanshme duke spostuar muret ndarëse dhe duke zaptuar korridorin e përbashkët të katit, duke e përfshirë atë në përdorim të njërive të tij.</p> <p>Si pasojë, më është bllokuar dhe penguar aksesimi i lirë për të hyrë në pronën time, duke cënuar drejtpërdrejtë të drejtën time të pronësisë dhe ushtrimin e aktivitetit tregtar.</p> <p>Theksoj se korridori është pjesë e përbashkët e ndërtesës dhe sipas legjislacionit në fuqi për bashkëpronësinë, nuk mund të tjetërsohet apo të përvetësohet nga asnjë bashkëpronar.</p> <p>Në këto kushte, kërkoj:  Verifikimin urgjent në terren nga ana e strukturave kompetente;  Konstatimin e shkeljes dhe marrjen e masave administrative përkatëse;  Lirimin e menjëhershëm të hapësirës të përbashkët (korridorit);</p>	25.02.2026	<p>Përhëndetje ,</p> <p>Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë</p> <p>Në dijeni:</p> <p>Në adresën-mai e lit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga , me nr. 18 Rendor, datë 24.02.2026</p> <p>Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur.</p> <p>Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>	E plote	Nuk ka

		Rivendosjen e gjendjes së mëparshme sipas projektit dhe dokumentacionit të miratuar.				
19	28.02.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Në faqen e pallatit ku ndodhet pjesa jonë e banimit, është ndërtuar një ashensor pa leje dhe pa miratimin apo firmën e asnjë prej banorëve.</p> <p>Disa banorë kanë kryer shtesa ndërtimore mbi tarracë, të cilat po na shkaktojnë probleme të vazhdueshme strukturore dhe shqetësime serioze.</p> <p>Jemi njoftuar gjithashtu për një vendim për ndërtimin e një ashensori brenda pallatit. Nga verifikimet tona rezulton se masat dhe hapësirat nuk përputhen me kushtet teknike, duke rrezikuar spostimin e shkallëve dhe sigurinë e banorëve. Theksojmë se kjo ndërhyrje po kryhet pa dakordësinë e banorëve të pallatit.</p> <p>Të gjitha këto veprime janë kryer pa transparencë dhe pa respektuar të drejtat e banorëve.</p>	03.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Drejtuar: IMT Bashkia Durrës Për dijëni:</p> <p>Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka

		<p>Ju lutemi të na ndihmoni dhe të ndërhyni për verifikimin e situatës dhe marrjen e masave të nevojshme, duke pasur parasysh se ne nuk jetojmë aktualisht në Shqipëri dhe e kemi të pamundur të ndjekim çështjen nga afër. Kemi besim të plotë tek ju për trajtimin korrekt të kësaj situate.</p> <p>Faleminderit për vëmendjen dhe mbetemi në pritje të një përgjigjeje.</p>					
20	28.02.2026	<p>Të nderuar,</p> <p>Nëpërmjet këtij emaili paraqes një ankesë zyrtare në emër të banorëve të Lagjes 15, zona Spitalë, Durrës, lidhur me një aktivitet grumbullimi dhe përpunimi kromi (rifuxho) që po zhvillohet prej vitesh në një zonë të banuar.</p> <p>Ky aktivitet zhvillohet shumë pranë banesave tona (rreth 20 metra larg), ku jetojnë fëmijë, të moshuar dhe familje të shumta. Kamionë me tonazh të rëndë hyjnë vazhdimisht në lagje, duke kaluar rreth 1 metër pranë shtëpive tona, me shpejtësi të lartë dhe me zhurmë të tmerrshme, duke rrezikuar</p>		<p>Përshëndetje,</p> <p>Në bashkëlidhje do të gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën/ankesën tuaj.</p> <p>Ju falënderojmë për mirëkuptimin.</p>			

		<p>seriozisht jetën dhe sigurinë tonë.</p> <p>Problemet kryesore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndotje e rëndë e ajrit (tymi, pluhur kromi, smog)</li> <li>- Zhurma të forta nga kamionët dhe makineritë që ngarkojnë/shkarkojnë kontenierë</li> <li>- Punë pa orar të caktuar, edhe gjatë natës deri në mëngjes</li> <li>- Përpunim i kromit në ambient të hapur, pa kapanone, pa filtra mbrojtës dhe pa masa mbrojtëse mjedisore</li> <li>- Probleme serioze me frymëmarrjen tek banorët</li> </ul> <p>Edhe pse kemi paraqitur ankesa të mëparshme, përgjigjja ka qenë se subjekti disponon leje mjedisore. Ne ngremë shqetësimin: si mund të jetë e mundur që një aktivitet i tillë i rëndë industrial të ketë leje mjedisore në një zonë kaq të populluar, ku shtëpitë janë vetëm disa metra larg vendit të përpunimit?</p> <p>Kërkojmë urgjentisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Verifikim në terren nga një inspektor për të parë situatën nga afër.</li> <li>2. Ndryshimin e menjëhershëm të</li> </ol>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>trasës së lëvizjes së kamionëve, pasi ka alternativa të tjera rrugore.</p> <p>3. Detyrimin e subjektit për ndërtimin e kapanonit të mbyllur për përpunimin e kromit.</p> <p>4. Respektimin e orarit zyrtar të punës (08:00 – 16:00).</p> <p>5. Zhvendosjen e kontenierëve dhe makinerive larg zonës së banimit.</p> <p>Jemi mbi 100 familje të rrezikuara dhe kërkojmë ndërhyrje të menjëhershme nga autoritetet për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë sonë.</p> <p>Në pritje të një reagimi urgjent,</p>				
21	12.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Në përgjigje të emailit tuaj ju përcjellim informacionin e kërkuar si më poshtë vijon:</p> <p>Në mars të vitit 2025 nuk rezulton të këtë ankesa/denoncime të depozituara pranë DRIKMT Shkodër nga banorët për nisjen e projektit “Blue Borgo”.</p> <p>Me shkresën me prot hyrës Nr. 104, datë 04.04.2025 nga ana e Komisarariatit të Policisë Shkodër jemi njoftuar për kryejën punimesh në pronën e shtetasit Fatmir Shpellza.</p>	26.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion.</p> <p>Ju faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka

	<p>Për trajtimin e rastit i jemi drejtuar IMT-Bashkia Shkodër me kërkesën për informacion dhe verifikim si organ kompetent për të ushtruar përgjegjësinë e kontrollit të territorit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, brenda territorit nën administrim.</p> <p>Nga IMT-Bashkia Shkodër me shkresën me prot hyrës Nr. 104/2, datë 16.04.2025 është përcjell informacioni se është ushtruar kontroll nga ana e tyre në vendin në fjalë, por në vend nuk janë gjetur përsona por vec mjete të parkuara, si dhe nga verifikimi janë konstatuar punime si sistemim dherash dhe bimësie. Nuk ka punime ndërtimore në kuptim të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.</p> <p>Gjithashtu ju bëjmë me dije se: me anë të postës elektronike me datë 03.02.2026 jemi vënë në dijeni për fillimin e punimeve me investitor Shoqëria “ABA BLUE BORGO” shpk, në objektin “Resorti Turistik përbërë me 33 struktura akomodimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, 1 strukturë akomoduese tip hotel</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>me 1 dhe 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, 3 struktura social kulturore me 1 dhe 3 kate mbi tokë”, me vendndodhje Baks Rrjoll në Bashkinë Shkodër.</p> <p>Me shkresën me prot hyrës Nr. 81/3 datë 09.02.2026 nga Shoqëria “ABA BLUE BORGO” është depozituar shkresa “Në vijim të Njoftimit të Fillimit të Punimeve Nr. 3 datë 30.01.2026” bashkëlidhur dhe dokumentacioni si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leja e Ndërtimit Nr. 360/1 datë 15.01.2026.</li> <li>- Vendimi i KKT-së Nr. 39 datë 17.12.2024.</li> <li>- Kontratë Sipërmarrje Nr. 14 Prot, datë 02.05.2025.</li> <li>- Kontratë Mbikqyrësi Nr. 397 Rep; Nr. 124 Kol datë 30.01.2026.</li> <li>- Licencë Zbatimi NZ. 4586/34 datë 16.09.2025.</li> <li>- Licencë projektimi Nr. 4586/18.</li> <li>- Licencë MK: 0349/7 datë 27.04.2023.</li> </ul> <p>Punë të mbarë!</p>				
22	11.03.2026	<p>Të nderuar!</p> <p>ju lutemi institucionit tuaj për vënie në dispozicion të</p>	27.03.2026	Përshëndetje,	E plote	Nuk ka

		<p>dokumenteve/informacioneve të mëposhtme</p> <p>Më konkretisht:</p> <p>1. Listën e plotë të kontrolleve dhe inspektimeve të kryera nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë pesë viteve të fundit lidhur me aktivitetin e nxjerrjes së inerteve apo gërmimeve në shtratin e lumenjve në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>2. Procesverbalet e inspektimit, akt-konstatimet dhe vendimet administrative të marra ndaj subjekteve që janë konstatuar në shkelje gjatë këtyre kontrolleve.</p> <p>3. Listën e subjekteve ndaj të cilave janë vendosur masa administrative (gjobë, pezullim aktiviteti apo bllokim punimesh) për ndërhyrje të paligjshme në shtratin e lumenjve.</p>		<p>Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion.</p> <p>Ju faleminderit.</p>		
23	09.03.2026	<p>Pershendetje!</p> <p>Doja një reagim nga institucioni juaj, sa i përket përdorimit të kateve të para dhe nëntokësore si</p>	25.03.2026	Deleguar IMT Bashkia Tiranë	E deleguar	Nuk ka

		<p>parkingje me pagesë, në komplekse në ndërtim në Tiranë.</p> <p>-Sa kontrole janë ushtruar në pallatet në ndërtim, që katet e para janë kthyer në parkingje me pagesë? Çfarë keni konstatuar?</p> <p>-A lejohet ky aktivitet, a plotësojnë standardet e sigurisë dhe çfarë masash keni marrë si institucion?</p> <p>Shkrimin e kam për publikim për të enjten, nëse është e mundur që komentin tuaj ta kem brenda ditës së mërkurë.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetem në dispozicionin tuaj për cdo sqarim të metejshëm.</p>				
24	17.03.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj ankesen.</p> <p>Faleminderit.</p>	01.04.2026	<p>Pershendetje,</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj pergjigjen per ankesen e ardhur prane IKMT.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka
25	18.03.2026	<p>Në zonën e Paskuqanit, pranë Bulevardit të Ri dhe buzë lumit të Tiranës, është duke u zhvilluar një ndërtim i madh që ngre</p>	01.04.2026	<p>Përhëndetje,</p> <p>Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të</p>	Ne proces	Nuk ka

		<p>shqetësime serioze mbi ligjshmërinë e tij.</p> <p>Ky rast është denoncuar pranë institucioneve përkatëse, përfshirë Policinë, Bashkinë Kamëz dhe IKMT, por deri më tani nuk ka pasur asnjë reagim apo ndërhyrje konkrete.</p> <p>Kërkohet transparencë dhe verifikim i menjëhershëm i situatës,</p>		<p>paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren.</p> <p>Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim.</p> <p>Faleminderit për bashkëpunimin</p>		
26	19.03.2026	<p>Po ndërtohet një vilë 2-katëshe pa leje.</p> <p>Kërkohet verifikim dhe ndërhyrje e menjëhershme nga institucionet përgjegjëse.</p>	01.04.2026	<p>Përhëndetje,</p> <p>Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren.</p> <p>Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim.</p> <p>Faleminderit për bashkëpunimin</p>	Ne proces	Nuk ka

27	21.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit,"dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike,ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm në lidhje me projektin Durrës Yachts &amp; Marina:</p> <p>A janë kryer inspektime në këtë zonë? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion një kopje të procesverbaleve të inspektimeve të kryera.</p> <p>A ka pasur konstatime teknike gjatë kontrolleve? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion një kopje të këtyre konstatimeve?</p> <p>Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>Duke ju falënderuar paraprakisht</p>	03.04.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Bashkëngjitur gjeni përgjigjen e kërkesës për informacion.</p> <p>Faleminderit.</p>	E plote	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	---------	--------

28	25.03.2026	<p>Nëpërmjet këtij denoncimi, kërkohet verifikimin e menjëhershëm në terren për dy objekte që po ndërtohen në zonën e Ksamilit, të cilat dyshohet se janë në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe pa leje ndërtimi.</p> <p>Nga verifikimet dhe vëzhgimet në terren, rezulton se: Janë ndërtuar struktura të qëndrueshme Punimet kanë vazhduar pa ndërprerje, pavarësisht mungesës së dokumentacionit të dukshëm ligjor Duke qenë se zona në fjalë është bregdetare dhe me rëndësi të veçantë publike, çdo ndërhyrje pa leje përbën shkelje të rëndë dhe kërkon reagim të menjëhershëm nga autoritetet kompetente.</p>	01.04.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren.</p> <p>Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim.</p> <p>Faleminderit për bashkëpunimin</p>	Ne proces	Nuk ka
29	26.03.2026	<p>Subjekti xxxxxx me Nipt xxxxxx ka ardhur ne pronen tone dhe ne vazhdim me fshatin xxxxxx, duke bere nje masaker mjedisore ( prerje pylli ) me qellim hapje kave guri .</p> <p>Prej atij momenti ne kemi jnoftuar inspektorin e policise se zones si dhe xxxxxx - xxxxxx dhe xxxxxx , por nuk na jane pergjigjur me asnje veprim ne terren apo proces verbal.</p>	01.04.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren.</p>	Ne proces	Nuk ka

		<p>Theksoj se ata kane dashur te mbrojne kolegun e tyre xxxxxx i cili punon ne xxxxxx, dhe qe njekohehisht eshte edhe aksioner ne shoqerine e lart permendur.</p> <p>Te njejten masaker mjedisore ky subjekt ka kryer edhe ne hyrje te fshatit xxxxxx - tek vendi i quajtur " xxxxxx " ( xxxxxx ).</p> <p>Me ane te kesaj ankese kerkoj nga ana e autoriteteve shteteroe , qe me anen e inspektoreve te tyre te verifikojne gjendjen ne terren dhe te marrin masat sipas legjislacionit ne fuqi.</p> <p>Prona private eshte e shenjte dhe shteti duhet ta garantoje ate.</p> <p>B/ lidhur gjeni foto si argument te ankeses se mesiperme</p> <p>Jemi ne pritje te pergjigjes TUAJ.</p> <p>Faleminderit per mirkuptimin.</p>		<p>Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim.</p> <p>Faleminderit për bashkëpunimin</p>		
30	26.03.2026	<p>Pas shume ankesave dhe denoncimeve ne IKMT Pogradec nuk kam marre asnje lloj zgjidhje te ketij problemi prandaj po ju drejtohem ju si autoriteti me i larte .</p> <p>Deme te cilat po shkaktohen edhe nga mungesa e serjozitetit te institucioneve perkatese qe po lejojne kte paligjshmeri dhe duke mos marre parasysht ankesat e mia te vazhdueshme</p>			Ne proces	

31	26.03.2026	Ne lidhje me proces-verbalin nr. 14, date 25.03.2026, Ksamil, paraqes kete ankim administrativ brenda afatit ligjor, duke kundërshtuar konstatimin e bere nga inspektorët.			Ne proces	
32	30.03.2026	Lumi Terkuze buron ne Boville edhe derdhet ne Adriatik, qe nga Bovilla ku deri ne Rinas jane mbi 40 pika inertesh te gjitha pa leje....Zona e bukur pika turistike e Bovillesh po shembet me mina dhe dinamit per inerte.... eshte nje nga kanionet me te bukura te shqiperise.... e gjitha po shembet pa leje.... pastaj me poshte ka nje derdhje masive inertesh qe nga zall herri deri ne Kamez.... miliona ton dhe jane derdhur.... gjerësia e Lumit nga 300/400 metra eshte kthyer ne nje kanal vadites	01.04.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren.</p> <p>Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim.</p> <p>Faleminderit për bashkëpunimin</p>	Ne proces	

*Shënim:*

<sup>1</sup> Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

<sup>2</sup> *Data e regjistrimit të kërkesave*

<sup>3</sup> *Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi*

<sup>4</sup> *Data e kthimit të përgjigjes*

<sup>5</sup> *Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi*

<sup>6</sup> *Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar*

<sup>7</sup> *Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.*